

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale shkelja e urdhrimit për mbrojtje nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen e Familjes, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.16/2016 të datës 22.01.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 01.02.2016 në seancën jo publike morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**M. S.** nga i ati R.dhe e ëma M. e lindur P. , i lindur me datë “data e lindjes”... në Prizren ku edhe tani jeton rruga “.. ..” nr. .., ka të kryer shkollën fillore, riparues i elektromotorave, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 02.01.2016 rreth orës 10:50 minuta, në Prizren rrugën “.. ..” në shtëpinë e tij familjare, për shkak të mosmarrëveshjes familjare në mesë të bashkëshortëve, të akuzuarit me vendim të gjykatës i ndalohet të hyjë në dhomën e palës së mbrojtur të dëmtuarës – bashkëshortes V. S. , por përkundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin C.nr.145/2015, i njëjti pasi që ishte i revoltuar për shkak të padisë së ushtruar nga ana e bashkëshortes për shkurorëzim, ai ndërmerri veprim dhe futet në dhomën e dëmtuarës edhe pse ajo kishte tërhequr vërejtjen që ta lë të qetë, mirëpo i akuzuari vazhdon që të qëndroj në dhomë përkundër ndalesës që kishte me aktvendim.

**Këso dore kryen veprën penale shkelje e urdhrimit për mbrojtje nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen e Familjes Nr.03/L-182.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 46, 73, 83 dhe nenit 25 të Ligjit për Mbrojtjen e Familjes Nr.03/L-182, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 600 € (gjashtëqind euro) në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 02.01.2016 e gjer më datën 01.02.2016, ashtu që çdo ditë të kaluar nën këtë masë do të hiqet nga 20 € për një ditë burg.

E dëmtuara V. S. nga Prizreni rruga “.. ..” nr. .. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.16/2016 të datës 22.01.2016 kundër të akuzuarit M. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale shkelja e urdhrit për mbrojtje nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen e Familjes.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në periudhën kohore me datë 02.01.2016, në Prizren në shtëpinë e tyre familjare, për shkak të problemeve bashkëshortore, si rezultat i revoltës pas që inicohet procedura e shkurorëzimit nga ana e palës së mbrojtur, i akuzuari M. S. me sjelljet e tij e shqetëson të dëmtuarën – bashkëshorten e tij V. S. nga Prizreni, i cili përkundrajt vërejtjes që e kishte bërë e dëmtuara që ta lë të qetë, ai ndërmer veprim dhe futet në dhomën e dëmtuarës. I akuzuari M. S. vazhdon që të qëndroj në dhomë përkundër ndalesës që kishte me aktvendim. Në këtë mënyrë e shkel obligimet që dalin nga urdhri për mbrojtje i cili ishte lëshuar me vendimin e Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin C.nr.145/2015, me të cilin i është urdhëruar të akuzuarit si person përgjegjës të mos shqetësoj të dëmtuarën si palë e mbrojtur.

I akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit. Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit. Gjykata sipas detyrës zyrtare pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale në të cilat është mbështetur aktakuza e prokurorit të shtetit nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari me kohë ka qenë i njoftuar në pajtim me nenin 246 e 244 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale shkelja e urdhrit për mbrojtje nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen e Familjes dhe për këtë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, gjendja e tij ekonomike, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla kundërligjore, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit,

duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.122/2016 të datës 01.02.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.